

## KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH.A.

Në bazë të Nenit 138 të Ligjit Nr. 02/L-123, të datës 17.05.2008, i plotësuar dhe ndërruar me Ligjin Nr. 04/L-006, të datës 23.06.2011 për Shoqëritë Tregtare, Nenit 34 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike të datës 13.06.2008, si dhe pikës 12.9 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve të KRU "Mitrovica" Sh.A. aprovoi këtë:

### RREGULLORE

*"Mbi veshjen dhe paraqitjen zyrtare të punonjësve  
në KRU "Mitrovica" Sh.A.*

Mitrovicë

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe fushëveprimi**

Me këtë rregullore përcaktohen standardet e veshjes dhe paraqitjes së punonjësve të Kompanisë Rajonale Ujësjetllësi "Mitrovica" SH. A.

**Neni 2**  
**Përkufizimi**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore janë:

1. **KRUM** - Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Mitrovica" SH. A
2. **Paraqitje apo dukje**-nënkupton paraqitjen dhe veshjen e të punësuarve për të përfaqësuar denjësisht punëdhënësin/kompaninë

**Neni 3**  
**Veshja dhe paraqitja në punë e të punësuarve**

1. Të punësuarit KRUM gjatë kohës që gjenden në detyrë zyrtare përmes veshjes dhe paraqitjes duhet të pasqyrojnë një imazh serioz dhe sa më profesional i cili korrespondon me ruajtjen e autoritetit dhe integritetit personal dhe të institucionit që përfaqëson i cili mund të këtë ndikim në perceptimin e publikut dhe të këtë ndikim të jashtëm sa i përket këtyre sjelljeve.
2. Paraqitja dhe veshmbathja gjatë gjithë kohës së orarit të punës duhet të përgjigjet vendit dhe detyrave të punës.
3. Paraqitja e të punësuarve duhet të jetë: e pastër, e rregullt dhe të kujdesen për higjienën personale.

**Neni 4**  
**Dukja personale dhe higjiena e të punësuarve**

1. Të punësuarit në KRUM duhet të paraqiten në punë të pastër dhe të kujdesen për higjienën personale të rrobave ose trupit.
2. Mustaqet, llojet e ndryshme të mjekrave i punësuarit mund të mbajë nëse mbahen të pastra dhe të prera mirë.
3. Tatuazhet janë të ndaluar në pjesët e dukshme të trupit, nuk lejohet grimi i tepërt.
4. Nuk lejohen kapelat, syzat e diellit gjatë orarit të punës (brenda zyrës).


**Neni 5**  
**Rregullat**

Punonjësve të KRUM nuk u lejohen veshje të tilla të cilat:

- Përcjellin mesazh vulgariteti e joshjeje dhe që ekspozohen pjese të ndryshme të trupit..
- Mesazh joshjeje, ose të turpshme e që klasifikohen si jo të denja për moralin shoqëror.

**Neni 6**  
**Veshja dhe paraqitja e të punësuarve**

Veshja dhe paraqitja e të punësuarve në KRUM duhet të jetë serioze dhe zyrtare, për ta përfaqësuar sa më denjësisht punëdhënësin në vendin e punës.



Për femrat lejohet:

- kostume (pantallona dhe setër) fustan (gjatësi minimum deri në gjunjë);
- këmishë, bluzë, xhemper të ndryshëm (Këmishat dhe bluzat duhet të mbulojnë pjesën më të madhe të krahërorit)
- xhaketë (jo sportive);
- këpucë me take të mesëm ose të shkurtra, sandale dhe çizme.

Për femrat nuk lejohen veshjet si:

- fund dhe fustane me gjatësi jo adekuate që nuk i përgjigjet natyrës së punës,
- fustane plazhi, fundet dhe fanella me shkëlqim, bluzat të shkurtra tek beli
- Xhinse të lekosura, veshje të tejdukshëm, veshje sportive (atlete, sandale plazhi, bluza me fotografi, logo apo shkronja dhe mbathje që paraqesin stil ekstravagant).
- Përrjashtimisht nga këto rregulla mund të ketë për veshjet joformale ku mund të lejohet veshja dhe me xhinse e cila duhet të jetë veshje e pastër e thjesht në mënyrë që të duket e përshtatshme edhe nëse ndodhë një takim rasti.

Për meshkuj lejohen veshjet si:

- kostume (pantallona të gjata dhe setër),
- këmishë, bluzë, xhemper,
- kravat (opcionale),
- xhaketë (jo sportive),
- këpucë

Për meshkuj nuk lejohen veshjet si:

- pantallonat e shkurtra, xhinse të lekosura, veshje sportive (sandale plazhi, bluza me fotografi logo apo shkronja).

#### **Neni 7**

#### **Rregullat e veshjes dhe të paraqitjes**

Rregullat e veshjes dhe të paraqitjes së punonjësve të KRUM janë:

- i. Mëngët e këmishave dhe bluzave/veshjes në përgjithësi nuk duhet të jenë aq të lira dhe të hapura sa të ekspozojnë trupin dhe veshjen e brendshme
- ii. Këmishat dhe bluzat duhet të mbulojnë pjesën më të madhe të krahërorit
- iii. Nuk lejohet të duket trupi ndërmjet veshjeve (jo veshje të tejdukshme)
- iv. Nuk lejohen pantallonat e shkurtër
- v. Flokët duhet të mbahen mire dhe të mos jenë të ngjyrosura me shumë ngjyra
- vi. Nuk lejohen veshjet sportive, veshjet me rripa, dekolte të thella, grimi i tepërt, mbathjet me taka tepër të larta apo ndonjë mënyrë tjetër ekstravagante e veshjes që nuk është e përshtatshme

#### **Neni 8**

#### **Mbikëqyrja dhe zbatimi i rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregullore përgjegjës janë mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i të punësuarit (drejtori përkatës i departamentit) i cili është i obliguar të përcjellë implementimin e rregullave të lartshënuara dhe nëse vihet re që ka mosrespektim të rregullave duhet t'i ndërmerr këto hapa:

- 1.1 Nëse veshmbathja dhe paraqitja e të punësuarit bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt duhet të bisedojë me të punësuarin dhe të mbajë evidencë lidhur me këtë,
- 1.2 nëse e njëjta gjë përsëritet në vazhdimësi nga i njëjti i punësuar, atëherë mbikëqyrësi duhet t'i paraqes masën disiplinore, vërejtje me gojë ose me shkrim të punësuarit sipas akteve ligjore në fuqi,
- 1.3 nëse përkundër vërejtjes nuk ka përmirësime dhe i njëjti i punësuar përsëritë sjelljen, atëherë mbikëqyrësi së bashku me faktet e më hershme të mbledhura duhet të paraqes tek Menaxhmenti më i lartë sipas hierarkisë (drejtori ekzekutiv) jo më vonë se 24 orë për inicim të procedurës disiplinore,
- 1.4 Në rast se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt dështon të raportojë për një shkelje të tillë atëherë mund të filloj procedura disiplinor ndaj tij/saj.

#### **Neni 9**

##### **Mospërfillja dhe zbatimi i rregullores**

Në rast të mospërfilljes së vërejtjes nga paragrafi 1.2 i Nenit 8 të kësaj rregullore, dhe vazhdimit të veshjes në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, udhëheqësi i drejtpërdrejt i bën vërejtje me shkrim punonjësit dhe e ruan në dosjen e tij/saj personale.

Nëse edhe pas vërejtjes me shkrim nga udhëheqësi i drejtpërdrejt, i punësuarit nuk sillet në përputhje me rregulloren, atëherë udhëheqësi i drejtpërdrejt ka të drejtën e inicimit të procedurave disiplinore pranë Komisionit disiplinor të Kompanisë.

#### **Neni 10**

##### **Mbikëqyrja rreth implementimit të rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregullore janë përgjegjës udhëheqësit e drejtpërdrejt të punonjësve të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" SH. A.

#### **Neni 11**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" SH. A.

KRU, Mitrovica,, Sh.A – Mitrovicë  
Kumrije Kelmendi Aliu - Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

